



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 03.07.2025.

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 (paragrafi 63.1.1) të Rregullores për Prokurim Publik /Nr.001/2022, të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 01.07.2025, të parashtruar nga Operatori Ekonomik "Rinesa" SH.P.K, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Rregullimi i shtratit të Lumit Krena - Faza finale", Nr. i prokurimit- Nr. i prokurimit- 632-25-1984- 5-1-1, Nr. i brendshëm-632-25-026-511, nxjerr:

V E N D I M

1. Refuzohet si e pabazuar kërkesa për ri-shqyrtim e Operatori Ekonomik "Rinesa" SH.P.K , e dt.01.07.2025, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Rregullimi i shtratit të Lumit Krena - Faza finale", Nr. i prokurimit- Nr. i prokurimit- 632-25-1984- 5-1-1, Nr. i brendshëm-632-25-026-511, kundër NJOFTIMIT MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, të datës 27.06.2025, të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së.

2. Vërtetohet NJOFTIMI MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, i publikuar me datë: 27.06.2025;

3.Autoriteti Kontraktues, vendos që të anuloj aktivitetin e prokurimit.

4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe publikohet në platformën elektronike të KRPP-së .

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik "Rinesa" SH.P.K, ka parashtruar kërkesës për ri-shqyrtim , me dt.01.07.2025, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Rregullimi i shtratit të Lumit Krena - Faza finale", Nr. i prokurimit- Nr. i prokurimit- 632-25-1984- 5-1-1, Nr. i brendshëm-632-25-026-511.

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 03.07.2025, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Pretendimet tuaja nuk qëndrojnë, sepse edhe pas kërimit të sqarimeve shtesë sipas nenit 72 të LPP-së, sqarimet tuaja nuk kanë qenë bindëse për Autoritetin kontraktues si në vijim:

Pika për sqarime 1:

- Pas kërkesës keni ofruar dëshmi shtesë për z. Armend Zaraj të cilin e keni prezantuar në listën e të punësuarve si gurëgdhendës, ndërsa si dëshmi shtesë keni ofruar certifikatë mbi aftësimin profesional ku z. Zaraj sipas kësaj certifikate ka fituar titullin e kualifikimit: Ndërtimtari;Murator, pas analizimit dhe krahasimit të certifikatave si dhe duke u mbështetur në kërkesën e dosjes së tenderit konsiderojmë se certifikata e ofruar nuk është konformë kërkesës së dosjes së tenderit dhe si e tillë nuk plotëson kërkesën në këtë pikë, sepse në dosje të tenderit është kërkuar certifikatë për gurëgdhendës ndërsa ju keni ofruar certifikatë për murator.

Pika për sqarime 2:

- Pas kërkesës për sqarime shtesë në lidhje me Kamionin me tabelat e regjistrimit 01-725-AZ, i prezantuar nga ju ku ne përshkrimin e tij ne certifikatën e regjistrimit të automjetit tregohet se është kokë tërheqëse e jo kamion kiper, për këtë pikë keni ofruar sqarime shtesë përmes fotografive (i fotografuar vetëm në pjesën e përparme) ku ky kamion duket se ka të bashkangjitur rimorkion me mekanizëm të kiperit, mirëpo nuk keni ofruar dëshmi të certifikatës së regjistrimit për rimorkion e cila është rimorkio e rëndë dhe në bazë të nenit 39 pika 1 dhe 2 e Ligjit Nr. 05/L-132 PËR AUTOMJETE ky mjet duhet të ketë certifikatë valide të regjistrimit, ju nuk keni prezantuar një certifikatë të tillë.

Dëshmitë shtesë të ofruara nga Ju nuk janë bindëse për të konstatuar se ky kamion është kamion me ndërtim-konstruksion kiper.

- Pas kërkesës për sqarime shtesë në lidhje me Kamionin me tabelat e regjistrimit 01-674-MH, keni ofruara si dëshmi DUD-in doganor ku sipas përshkrimit në DUD-in doganor ky kamion plotëson kërkesën në këtë pikë të dosjes së tenderit.

Pika për sqarime 3:

- Pas kërkesës për sqarime shtesë në lidhje me Fatura me nr. FACTURE 515354 nga PROCEQ, ju keni ofruar këtë dokument të përkthyer në gjuhën shqipe nga përkthyesi gjyqësor z. Izet Sylaj. Pas sqarimeve kjo pikë plotëson kërkesën e tenderit.

Pika për sqarime 4:

- Pas kërkesës për sqarime shtesë nuk keni ofruara sqarime bindëse për këtë pikë. Po ashtu nuk keni ofruar dëshmi se ju posedoni ose partnerët me të cilët keni marrëveshje posedojnë licencë valide për shfrytëzim të rrës dhe zhavorrit të lëshuar nga Komisioni

i Pavarur për Miniera dhe Minerale (KPMM). Kjo pikë nuk e plotëson kërkesën e dosjes së tenderit.

Pika për sqarime 5:

- Pas kërkesës për sqarime shtesë nuk keni ofruara sqarime bindëse për këtë pikë. Po ashtu nuk keni ofruar dëshmi se ju posedoni ose partnerët me të cilët keni marrëveshje për këtë tender posedojnë Licencë për Administrimin e Mbeturinave të lëshuar nga organi kompetent. Kjo pikë nuk e plotëson kërkesën e dosjes së tenderit.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si në dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . **Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimi te ketij vendimi.**

Faton Gutaj

Menaxher i Zyrës së Prokurimit

Kopje: Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit te Komunës;
Te gjitha palëve te interesuara;

